

09.03.2022
Ora 16:37

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe dhënien e mandatit të kryetarit të bashkisë zotit Bardh Ali Spahia”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Atëherë, fillojmë me shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me projektvendimin “Për miratimin e rezultatit të zgjedhjeve për kryetarin e Bashkisë Shkodër dhe dhënien e mandatit”,
projektvendimin “Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Durrës dhe dhënien e mandatit”,
dhe projektvendimin “Për miratimin e rezultatit të zgjedhjeve për kryetar të Bashkisë Lushnje dhe dhënien e mandatit përkatës”.
Atëherë fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Në datën 6 mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet në Bashkinë Shkodër për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie. Pasi përfundoi procesi i dorëzimit të tabelave të rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi për kryetar bashkie, nga të katër KZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 09.03.2022*

duhet të nxjerrë rezultatin për këtë bashki, duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë KZAZ, në bazë të tabelave të rezultatit të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse. Përpara plotësimit të tabelave përmbljedhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar bashkie të Bashkisë Shkodër, u krahasua me tabelat e rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre KZAZ-ve, të plotësuara nga anëtarët e grupit të numërimit, me tabelat përmbljedhëse të rezultatit të miratuara nga KZAZ-ja nr. 2, 3, 4 dhe 5 dhe rezultatin e tyre të hedhur në sistemin elektronik dhe rezultoi si më poshtë.

Tabela përmbljedhëse e rezultatit të miratuar nga KZAZ-ja nr. 2, 3, 4 dhe 5 përfshin rezultatin e të gjitha tabelave të rezultatit të qendrave të votimit që kanë këto ZAZ, me përjashtim të qendrave të votimit nr. 0092, 0132 dhe 0133, të KZAZ-së nr. 2, ku nuk u zhvilluan zgjedhjet.

Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi, me tabelat përmbljedhëse të rezultatit të ZAZ-ve përkatëse, rezultatet e tyre të hedhura në sistemin elektronik u vërejtën mospërputhje të shifrave si më poshtë:

për qendrën e votimit nr. 0308/1, numri i zgjedhësve që kanë votuar nga grupi i numërimit është rezultuar 165, nga tabela përmbljedhëse e rezultatit është 156 dhe në sistem është 156;

për qendrën e votimit nr. 0308/1, fletët e votimit të gjetura në kuti, nga grupi i numërimit janë konstatuar 165 fletë votimi, nga tabela përmbljedhëse e rezultatit është 165 dhe sistemi 165.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim tabelën përmbljedhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Shkodër me shifrat e korigjuara,

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 09.03.2022*

mbështetur në origjinalen e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi të kësaj bashkie, të plotësuara nga anëtarët e grupeve të numërimit.

Bazuar në nenin 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme, të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, dhe neni 123 dhe 166 të Kodit Zgjedhor vendos:

Të miratoj tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

T’i jap mandatin e kryetarit të Bashkisë Shkodër, zotit Bardh Ali Spahia, të propozuar nga koalicioni “Shtëpia e Lirisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij në KAS.

Vendim nr. 134

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



09.03.2022

Ora 16:41

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe dhënien e mandatit të kryetarit të bashkisë zonjës Emiriana Hqmet Sako”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja**
- **Parti Politike:** **S’ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Në datën 6 mars 2022 u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në Bashkinë Durrës. Në përfundim të procesit të dorëzimit të tabelave të rezultateve dhe tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi për kryetar të Bashkisë Durrës nga të katër KZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të nxjerrë rezultatit për këtë bashki duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit, të njësisë së qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy ose më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ të kësaj zone zgjedhore përkatëse. Përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit, për zgjedhjen e kryetarit të

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 09.03.2022*


Bashkisë Durrës, u krahasuan me tabelat e rezultatit për kandidatët për kryetar të qendrave të votimit të këtyre ZAZ-ve, të plotësuara nga anëtarët e grupit të numërimit me tabelat përmbledhëse të rezultatit të miratuara nga ZAZ-ja nr. 21, 22, 23 dhe 24 me rezultatin e tyre të hedhur në sistemin elektronik, dhe rezultoi se tabela përmbledhëse e rezultatit të miratuar nga ZAZ-ja nr. 21, 22, 23 dhe 24, përfshin rezultatin e të gjitha tabelave të rezultatit të qendrave të votimit të këtyre ZAZ-ve, me përjashtim të qendrës së votimit nr. 1416, të ZAZ-së nr. 22, ku me vendim të KZAZ-së, kutia e fletëve të votimit është shpallur e parregullt. Nga krahasimi i tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi me tabelat përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së përkatëse, dhe rezultatit të tyre të hedhur në sistemin elektronik, u vërejtën mospërputhje të shifrave si më poshtë:

për qendrën e votimit nr. 1328, fletët e votimit të papërdorura nga grupi i numërimit janë konstatuar 321, nga tabela përmbledhëse e rezultateve është 32, dhe në sistem është 32;

për ZAZ-në nr. 22, Bashkia Durrës, qendra e votimit 1458/1, numri i zgjedhësve që kanë votuar ka rezultuar nga grupi i numërimit 674, nga tabela përmbledhëse e rezultatit është 674, dhe në sistem 674.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, me shifrat e korigjuara, të mbështetura në origjinalet e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, të plotësuara nga anëtarët e grupeve të numërimit. Referuar nenit 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy ose më shumë ZAZ, në bazë të tabelës së rezultatit për çdo ZAZ, të zonës zgjedhore përkatëse. Bazuar nenit 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 09.03.2022*

votuar në këtë njësi vendore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, pika 2, nenet 123 dhe 166, të Kodit Zgjedhor vendos:

Të miratoj tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen për kryetar të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

T’i jap mandatin e kryetarit të Bashkisë Durrës, zonjës Emiriana Hiqmet Sako, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga data e shpalljes së tij, në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendim nr. 135

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



09.03.2022

Ora 16:44

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për miratimin e rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë Lushnjë, qarku Fier, në zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022 dhe dhënien e mandatit të kryetarit të bashkisë zonjës Eriselda Musa Sefa".

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y. Merkaç, M. Koja**
- **Parti Politike:** **S'ka**
- **OJQ** **KRIK**

Z. I. Celibashi: Pika e fundit e rendit të ditës!

Z. Y. Merkaç: Në datën 6 mars 2022, në Bashkinë Lushnje u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Lushnje. Pasi përfundoi procesi i dorëzimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit dhe tabelave të rezultatit për çdo qendër votimi për kryetar bashkie, nga dy ZAZ-të e kësaj bashkie, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të nxjerrë rezultatin për këtë bashki duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor. Referuar nenit 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikon dhe nxjerr rezultatet e votimit për çdo njësi të qeverisjes vendore, territori i së cilës është i përbërë nga dy apo më shumë ZAZ. Përpara plotësimit të tabelave përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Lushnje, u krahasuan me tabelat e rezultatit për kandidatët për kryetar të çdo qendre votimi të ZAZ-ve, të plotësuara nga anëtarët e grupit të

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt 09.03.2022*

numërimit me vendimet e marra nga KZAZ-ja nr. 54 dhe 55 dhe rezultatet e tyre të hedhura në sistemin elektronik të votimit, ku rezultoi se qendra e votimit nr. 2872, vota të pavlefshme të konstatuara nga grupi i numërimit janë 9, nga tabela përmbledhëse e rezultatit janë 8, dhe në sistem janë 8. Për këto qendra votimi, vota të vlefshme janë 187 nga grupi i numërimit, nga tabela përmbledhëse e rezultatit është 188 dhe në sistem janë 188. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton me vendim tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Lushnje, Qarku Fier, me shifrat e korigjuara, mbështetur në origjinalet e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi, të kësaj bashkie, të plotësuara nga anëtarët e grupeve të numërimit. Bazuar në nenin 166, pika 1 të Kodit Zgjedhor, kryetar bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në këtë njësi vendore zgjedhore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, si dhe nenet 123 dhe 166 të Kodit Zgjedhor vendos:

Të miratoj tabelën përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të Bashkisë Lushnje, Qarku Fier, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

T’i jap mandatin e kryetarit të Bashkisë Lushnje, zonjës Eriselda Musa Sefa, të propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 orëve nga shpallja e tij, në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

Vendim nr. 136

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

